




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR  
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES



Strategjia  
për  
ndërveprim mes Sipërmarrjes  
dhe  
Institucioneve publike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KRYEMINISTRIA**  
MINISTRE SHTETI PËR  
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

# Preambul

Tipologjia e raportit Publik-Privat qëndron në thelb të debatit mbi zhvillimin ekonomik. Asnjë vend nuk ka mundur të shënojë rritje ekonomike, pa një shtet të fortë i cili të partnerizojë me sipërmarrësin duke ofuruar të mira publike kyçe si siguria e pronës, zbatueshmëria e ligjit apo përshtatja dhe përmirësimi i infrastrukturës. Shqipëria tashmë ndodhet në një moment themelor për të ardhmen e saj ekonomike. Angazhimet e ndërmarra në kuadrin e Strategjisë së Evropës Juglindore 2020 dhe Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, ndjekur nga aksioni kundër informalitetit, si dhe reforma e deregulimit shoqëruar me lehtësimin e procedurave dhe burokracive në administratën publike, janë tregues i qartë i vullnetit të kësaj Qeverie për ta shndërruar Shqipërinë në portë hyrëse në tregëtinë rajonale.

# Vizioni



Vizioni themelor i zyrës së Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes përqëndrohet në krijimin e një mekanizmi që mundëson bizneset të kanalizojnë dhe të avokojnë shqetësimet dhe propozimet e tyre për Qeverinë, si dhe një mekanizmi për të ndërmjetësuar dhe lehtësuar komunikimin mes sipërmarrjes dhe institucioneve publike në rast mosmarrveshjes.

Realizimi i këtij vizioni do të rezultojë në reduktim të pengesave administrative në fushat e evidentuara si më problematike për bizneset dhe në një partneritet më të ngushtë publik-privat, duke përmirësuar kështu cilësisht shërbimet publike ndaj sipërmarrjes dhe klimën e biznesit në Shqipëri.

# Prioritetet



Qasja e ndërmarrë nga Ministrja e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, do të realizojë një partneritet dhe bashkëpunim të ngushtë dhe të ndërsjellë ndërmjet sipërmarrjes dhe institucioneve publike. Këshilli Ekonomik Kombëtar, nën varësinë e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dhe Sekretariati Teknik i këtij këshilli, do të shërbejnë si instrumentë themelor në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e këtij bashkëpunimi nëpërmjet:

- Promovimit të bashkëpunimit dhe transparencës ndërinstitucionale në funksion të ndihmës ndaj bizneseve dhe përmirësimit të shërbimeve publike ndaj sipërmarrjes.
- Mbrojtjes të së drejtave ligjore të sipërmarrjes nëpërmjet këshillimit dhe asistencës në komunikimin me administratën shtetërore.
- Reduktimit të problematikave të sipërmarrjes si rrjedhojë e mirëkordinimit ndërmjet institucioneve publike.
- Përmirësimit të klimës së biznesit në Shqipëri me synim nxitjen e investimeve të huaja në vend dhe zgjerimin e aktiviteteve ekzistuese.
- Nxitjes së punësimit në Shqipëri, me vëmendje të theksuar në promovimin e punësimit në sektorin privat krahasimisht me preferencën për administratën publike.

# Objektivat



Jetësimi i synimeve dhe prioritetve të Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, konform vizionit dhe qëllimit të saj fillestar do të realizohen nëpërmjet:

- Garantimit të bashkëpunimit institucional dhe partneritetit publik-privat për zhvillimin e politikave ekonomike nëpërmjet funksionimit të sekretariatit teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar në varësi të MMS.
- Ngritjes së platformave elektronike për ndërveprimin e sipërmarrjes me zyrën e Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Platformat do të garantojnë një komunikim intensive dhe të vijuar.
- Trajtimit të ankesave administrative të ndërmarrjeve private kundër institucioneve publike të qeverisjes qendrore dhe lokale dhe zyrtarëve të tyre.
- Hartimit të propozimeve mbi ndryshime të kuadrit ligjor në favor të përmirësimit të klimës së biznesit. Këto propozime do të pikasen nga rezultatet e problematikave të adresuara nga biznesi vetë si dhe nga paketat propozuese dërguar nga vetë organizatat përfaqësuese të biznesit apo grupet e interesit në Shqipëri.
- Përmirësimit të renditjes së Shqipërisë në raportet ndërkombëtare të biznesit. (ex. Doing Business)
- Rritjes së bashkëpunimit për nxitjen e më shumë investimeve vendase dhe të huaja në Shqipëri.
- Përmirësimit të dialogut ndërmjet sipërmarrjes private dhe botës akademike, me qëllim përgatitjen e burimeve njerëzore në përputhje me nevojat aktuale të tregut të punës në Shqipëri.

# Arritjet



Zyra e Ministres së Shtetit për Mbrojtjen e sipërmarrjes gjatë aktivitetit të saj, do të mundësojë një komunikim të vazhduar me sipërmarrësit dhe qytetarët, me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj tyre, klimës së biznesit dhe komunikimit. Gjithashtu nëpërmjet advokatimit të komunitetit të biznesit pranë Këshillit të Ministrave, ajo do të bëjë të mundur bashkëqeverisjen nëpërmjet:

- Ngritjes së një strukture efikente për trajtimin dhe ndjekjen e ankesave të adresuara nga sipërmarrja. Në përmbyllje të mandatit garantohej reduktimi i problematikave të sipërmarrjes vendase dhe të huaj ndaj administratës shtetërore.
- Trajtimin në masë 100% të ankesave të ardhura nga sipërmarrja drejt Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, me një marzh zgjidhjeje prej më shumë se 60%.
- Botimit dhe shpërndarja së 12 raporteve (për 12 muaj) mbi trajtimin e ankesave të sipërmarrjes, në shqip dhe anglisht.
- Hartimit të katër paketave propozuese mbi përmirësimin e kuadrit ligjor në funksion të zhvillimit të sipërmarrjes. Në përmbyllje të mandatit garantohej përmirësimi i kuadrit ligjor në favor të mbarëvajtjes së sipërmarrjes në Shqipëri. Gjithashtu, në linjë dhe me reformën e thellë të derregulluese të ndërmarrë nga Qeveria, do të mundësohet dhe lehtësimi i procedurave burokratike me të cilat haset biznesi në të gjitha stadet e zhvillimit.
- Hartimit të rekomandimeve konkrete të formuluar në bashkëpunim me komunitetin e biznesit dhe përfaqësisë së universiteteve, me qëllim hartimin e politikave më të mira të Qeverisë për nxitjen e punësimit në vend ne përputhje me nevojat aktuale të tregut.

# Pasqyra e Lëndës



1.	Preambul.....	2
2.	Vizioni .....	3
3.	Prioritetet.....	4
4.	Objektivat.....	5
5.	Arritjet.....	6

